



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr.104/02-16334

PROCESVERBAL:

Dëgjim buxhetor:

Buxhetin për vitin 2024 dhe planifikimet për vitet 2025-2026 me banorët e lokaliteteve Begracë, Kaçanik i Vjetër, etj

Data: 01.08.2023

Vendi: Shkolla Filllore “ Qamil Ilazi” Kaçanik i Vjetër

Ora: 20:00

Komuna e Kaçanikut përmes Drejtorisë për Buxhet dhe Financa e cila ka hartuar draft buxhetin për vitin 2024, duke u bazuar në ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, dhe nenin 6 pika 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna,, organizoi dëgjim buxhetor me banorët e lokaliteteve Begracë, Kaçanik i Vjetër, etj

Data: 01.08.2023

Vendi: Shkolla Filllore “ Qamil Ilazi” Kaçanik i Vjetër

Ora: 20:00

Fillimisht takimin e hapi Drejtori Buxhet dhe Financa Bahri Selimi, i cili foli në përgjithësi për projeksionet e buxhetit për vitet e ardhshme, ndërsa pjesë e panelit ishin edhe Drejtori për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit Qamil Stagova si dhe Drejtori për Shërbime Publike dhe Emergjencia Ramadush Osmani.

Të pranishmit në takim, një zëri kërkuan zgjidhjen e problemit me ujë të pijes, ndërsa poashtu kërkuan edhe rregullim të trotuareve në zonën Kaçanik të Vjetër si dhe mirëmbajtje të tyre si dhe poashtu rregullim të rrjetit të kanalizimit.



Procesmbajtësi
Fatlume Guri Selimi